

**AlProfit Consult**

Zyrë Kontabiliteti

**Ne ndihmojmë**

**Në rritjen e biznesit tuaj**

Adresa: Rruga e Elbasanit, Pallati Fratari, Shkalla 1, Kati 6, Apartamenti 27, Tiranë

Telefon: +355 693232349

Web: [www.alprofitconsult.al](http://www.alprofitconsult.al)

E-mail: [info@alprofitconsult.al](mailto:info@alprofitconsult.al)

Maj 2020

## Përmbajtja

HYRJE.....	3
RRETH NESH .....	3
Avantazhet .....	3
Ekipi jonë.....	4
SHËRBIMET.....	5
Shërbime Kontabiliteti .....	5
Shërbime Taksash .....	5
Konsulencë Financiare .....	6
Regjistrimi i Bizneseve .....	7
Intuit QuickBooks.....	8
Kurse Kontabiliteti.....	8
KONTAKT .....	9

## HYRJE

*Konsulentë të përkushtuar për të ndihmuar klientët tanë për të pasur sukses*

### Shërbime kontabiliteti, Taksash dhe Konsulencë financiare

Alprofit Consult është një studio e pavarur e cila ofron shërbime kontabiliteti, shërbime të administrimit të taksave dhe shërbimeve të konsulencës financiare se bashku me shërbime të trajnimeve në këto fusha. Ne ofrojmë një paketë të plotë të shërbimeve profesionale të personalizuar ndaj bizneseve dhe individëve që dëshirojnë të përfitojnë nga këto shërbime.

Edhe nëse aktiviteti juaj është i ri ose ekzistues, organizatë jo-fitimprurëse apo biznes në një industri të caktuar, Alprofit Consult mund t'ju ndihmojë që të përmbushni objektivat tuaja duke ju mbështetur me shërbime të konsulencës financiare që plotësojnë nevojat tuaja unike. Si klienti ynë, ju do të përfitoni nga qasja në ekipin tonë të besueshëm financiar dhe shërbimet tona të përshtatshme, teknologjikisht të avancuara.

Në Alprofit Consult ne jemi të përkushtuar për të siguruar që klientët tanë të kenë burimet që kanë nevojë për të optimizuar gjendjen e tyre financiare dhe operacionet e biznesit. Ne mirëpresim mundësinë për të mësuar më shumë për nevojat tuaja të shërbimeve financiare dhe se si mund t'ju ndihmojmë.

## RRETH NESH

### Avantazhet

Ne e pranojmë se zgjidhja e konsulentit financiar është një vendim shumë individual dhe që ofron mundësinë e sigurimit të përfitimeve dhe qetësisë tuaj në të ardhmen. Me kapacitetin e stafit tonë ne synojmë që të përmbushim pjesën më të madhe të nevojave të klientëve tanë për konsulencë financiare dhe manaxheriale.

Zgjedhja e Konsulentit “të përshtatshëm” do të ketë në të ardhmen një ndikim të rëndësishëm mbi ju dhe aktivitetin tuaj. Ne ju mirëpresim të kuptoni dhe përqafoji qasjen tonë. Në AlProfit Consult, klientët dhe bashkëpunëtorët tanë, na tregojnë që ata janë të kënaqur të punojmë së bashku me ne, sepse:

- ✓ Qasja ndryshe. Ne synojmë që të ofrojmë shërbime sa më të specializuara si edhe me vlerë të shtuar për klientët tanë. Qëllimi primar është jo thjesht ofrimi i shërbimeve rutinë të një studio kontabël por ngritja e një strukture që do të mundësojë mbështetjen e klientëve tanë në punën dhe detyrat e tyre të përditshme.
- ✓ Edukimi. Ne kemi edukimin dhe certifikimin e nevojshëm për të mbuluar shërbimet të cilat ofrojmë. Ekipi ynë është i përbërë nga profesionistë që zotërojnë tituj të ndryshëm profesionalë dhe certifikime të ndryshme, si Auditues Ligjorë (që nuk e ushtrojnë aktualisht profesionin), Kontabilist i Çertifikuar nga ACCA, Kontabël të Miratuar, Master Shkencor në fushën e Kontabilitetit dhe të diplomuar në fusha të ndryshme të Shkencave ekonomike.
- ✓ Eksperienca. Ne kemi eksperiencë të gjatë dhe gjithëpërfshirëse në fushat në të cilat ne ofrojmë shërbime tona. Ekipi ynë dhe bashkëpunëtorët tanë kanë mbajtur pozicione të ndryshme dhe të rëndësishme në administrimin dhe vendimmarrjen e biznesit ku ata kanë punuar. Profili i bashkëpunëtorëve tanë përfshin: Ekonomistë, Drejtues të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, Pedagogë pranë Institucioneve të arsimit të lartë, Profesionistë të pavarur të fushave, etj.
- ✓ Fleksibël. Ne ofrojmë shërbime të personalizuar dhe kemi kapacitetin që të përshtatemi me ndryshimet në kërkesat e klientit. Ne synojmë që të krijojmë marrëdhënie sa më afatgjatë me

klientët tanë. Kjo realizohet duke ofruar shërbime sa më profesionale, të personalizuar, fitimprurëse dhe duke u mbështetur zhvillimeve më të fundit teknologjike.

- ✓ Ju dëgjojmë. Ne marrim kohën e nevojshme për të dëgjuar rreth situatës dhe rastit tuaj.
- ✓ Jemi Pranë Jush. Ne jemi prezent dhe gjejmë gjithmonë kohën për të dëgjuar dhe folur me Ju.

## Ekipi jonë

### ANDI HAXHILLARI

Ideator dhe themelues

Është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në degën Ekonomiks në vitin 2007. Në vitin 2011 ka përfunduar studimet pas universitare në fushën e Kontabilitetit.

Në vitin 2012 ka fituar titullin profesional “Kontabël i Miratuar” nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).

Ka eksperiencë prej më shumë se 10 vjetësh në fushën e financës dhe kontabilitetit. Ka punuar në detyra të ndryshme pranë Prespa Invest, Meggle Albania, Dealb Konstruksion, Bota e Verës, Vesa Solutions etj.

Aktualisht është lektor i jashtëm pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Ka qenë pjesë e trupit akademik të Universitetit të Tiranës, si asistent pedagog i jashtëm.

### STELA VERO

Shërbimi i klientit

Është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës në degën Inxhinieri Ekonomike, në vitin 2016. Në vitin 2018 ka përfunduar studimet pas universitare.

Ka eksperiencë prej më shumë se 3 vjet në detyra të regjistrimit dhe përpunimit të të dhënave, statistikës, zbatimit të projekteve dhe të tjera.

Ajo është pjesë e studios së kontabilitetit nga viti 2019 dhe përmbushur përgjegjësi që lidhen me regjistrimin e të dhënave, raportime tatimore, shërbimi i klientit dhe detyra të tjera administrative.

### ERJON SKORDHA

Partner i jashtëm

Është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dega Financë - Kontabilitet në vitin 2009. Në vitin 2011 ka përfunduar studimet pas universitare në fushën e Kontabilitetit.

Në vitin 2016 ka fituar titullin prestigjioz “Kontabilist i Çertifikuar” pranë ACCA (Association of Chartered Certified Accountants), shoqata më e madhe Ndërkombëtare e Kontabilitetit.

Aktualisht është LIDER në fushën e trajnimeve për programet e Kontabilitetit Financiar, Kontabilitetit të Drejtimit dhe Menaxhim Operacionesh me mbi 3,000 studentë të trajnuar për këto programe në 5 vitet e fundit. Ka punuar si Analist Biznesi dhe Konsulent për Microsoft Navision.

Zotëron një gamë të gjerë kualifikimesh midis të tjerash Microsoft Certified Professional - Profesionist i Çertifikuar nga Microsoft për Programin ERP Microsoft Navision.

# SHËRBIMET

## Shërbime Kontabiliteti

Ne mund t'ju ndihmojmë me mbajtjen e kontabilitetit, rishikim dhe përgatitjen e pasqyrave financiare

Kontabiliteti është gjuha e biznesit, dhe ashtu si çdo komunikim, ky informacion duhet të jetë i shpejtë, në kohë reale, i kuptueshëm dhe i përshtatur për çdo rast. Ai duhet, mbi të gjitha, ti shërbejë qëllimit të marrjes së vendimeve.

Ne mund të realizojmë ngritjen e një sistemi të informacionit kontabël që mundëson informacion të plotë dhe në kohë reale. Shërbimi ynë i zyrës së kontabilitetit ofron raportim të plotë dhe analizë kritike që ju lejon të vlerësoni shëndetin financiar të aktivitetit tuaj dhe të realizoni qëllimet tuaja të biznesit.

Ndryshimet e shpejta teknologjike kanë sjellë gjithashtu mundësi të mrekullueshme për përshtatjen e sistemeve të informacionit kontabël dinamike dhe që bashkojnë shumë aktorë të sipërmarrjeve. Ky sistem informacioni nuk mund dhe nuk duhet të jetë vetëm një plan llogarish dhe gjuhe e koduar vetëm për kontablistët, por burim i paçmueshëm informacioni.

Ne do të vlerësojmë të gjitha proceset tuaja të biznesit për të konceptuar së bashku sistemin më të mirë të informacionit kontabël dhe qarkullimit të dokumentacionit. Kështu do të kemi mundësi për të përfshirë të gjithë aktorët që marrin pjesë në punën tuaj dhe marrë informacion në kohë reale.

Zyra jonë e kontabilitetit mund t'ju ndihmojë duke përgatitur raporte të ndryshme financiare ose duke ofruar shërbim të plotë të mbajtjes së informacionit kontabël. Duke ju dhënë mundësi që Ju ndërkohë të fokusoheni në drejtimin e biznesit tuaj.

Ne do të punojmë së bashku për të planifikuar punën tonë të përditshme, në administrimin e gjithë sistemit të kontabilitetit, jo vetëm si detyrë, por si burim i pazëvendësueshëm

Analiza jonë financiare do t'ju japë një shikueshmëri më të mirë në faktorët që drejtojnë biznesin tuaj.

Paketa e plotë e shërbimeve kontabël.

- ✓ Mbajtja e plotë e llogarive tuaja.
- ✓ Ngritjen e sistemit të informacionit kontabël.
- ✓ Përgatitja e pasqyrave financiare.
- ✓ Rishikim i raportimeve dhe të dhënave kontabël.
- ✓ Raporte dhe analiza të ndryshme për qëllime të vendimmarrjes.

Ne ju ftojmë që të përfitoni nga konsultimi ynë i parë falas për të diskutuar rreth kërkesave tuaja të shërbimeve të kontabilitetit në biznesin tuaj. Ju lutemi telefononi në +355693232349, ose shkruani në [info@alprofitconsult.al](mailto:info@alprofitconsult.al) për të lënë një takim.

## Shërbime Taksash

Ne mund t'ju ndihmojmë me deklaratimet tatimore, informojmë për ndryshime ligjore dhe administrojmë taksat

Ne e dimë se një nga qëllimet tuaja kryesore është të paguani nivelin e duhur të taksave. Kjo arrihet më së miri nëpërmjet planifikimit gjithëpërfshirës të taksave, së bashku me zyrën e kontabilitetit.

Administrimi i taksave është një nga fushat më të ndjeshme për sipërmarrjet sepse, administrimi i tyre efektiv sjell menaxhimin dhe uljen e mundshme të tyre por nga ana tjetër risqet që hasin bizneset nga shkelja e ligjeve në këto fusha, nga mosnjohja dhe mos përditësimi në kohën e duhur, sjell penalizimin e tyre.

Sistemi i administrimit të taksave, ashtu si vetë profesioni i ekonomistit, ka ndryshuar ndjeshëm kohët e fundit. Tashmë nuk është i nevojshëm vetëm të kuptuarit pasiv të legjislacionit por ndërveprim real dhe i shpejtë për tu përshtatur me të.

Nevojitet marrja e vendimeve në kohën e duhur, që në fazën e hartimit të planit tuaj dhe më pas zbatimit të tij hap pas hapi. Përfshirja e administrimit të sistemit tatimor në erën e shpejtë të zhvillimit të informatizimit të shumë proceseve, kërkon përshtatje të shpejtë dhe ndryshim të mendësisë për rolin e sistemit tatimor.

Nëse pothuajse të gjitha proceset e kryerjes së deklarimeve tatimore, ashtu si shumë procese të tjera të profesionit të ekonomistit, por dhe më gjerë, do të automatizohen, e gjithë energjia për administrimin e taksave nevojitet në planifikimin e tyre dhe marrjen e vendimeve në kohën e duhur.

Ne nuk paraqitemi tek ju vetëm për të hartuar deklaratën mujore ose vjetore në fund të periudhës, por, energjia jonë më e madhe është e fokusuar në hartimin e strategjisë më të mirë dhe, pastaj, kontrolli të vazhdueshëm, përpara plotësimit të deklaratës finale. Kështu, ne do të kemi kohë, së bashku, për të marrë vendime në kohën e duhur.

Ne punojmë me ju gjatë gjithë vitit për të zhvilluar një plan të përshtatur me strategji të kursimit për situatën tuaj.

Paketa e plotë e shërbimeve të taksave.

- ✓ Planifikim i pagesës së taksave.
- ✓ Kryerja e të gjitha deklarimeve tatimore referuar legjislacionit në fuqi.
- ✓ Ndjekja e procedurave gjatë kontrolleve të ndryshme tatimore.
- ✓ Asistencë e vazhdueshme për personelin përgjegjës.
- ✓ Rishikim i deklarimeve tatimore periodike.
- ✓ Informim i vazhdueshëm i ndryshimeve më të fundit ligjore.

Ne ju ftojmë që të përfitoni nga konsultimi ynë i parë falas për të diskutuar rreth kërkesave apo pyetjeve tuaja në për çështje të ndryshme fiskale. Ju lutemi telefononi në +355693232349, ose shkruani në [info@alprofitconsult.al](mailto:info@alprofitconsult.al) për të lënë një takim.

## Konsulencë Financiare

Ne mund t'ju ndihmojmë me shërbime të ndryshme të konsulencës financiare për biznesin tuaj

Ne mendojmë që biznesit janë të interesuar që, përveç shërbimeve rutinë, të zyrës së kontabilitetit, të përfitojnë edhe shërbime të tjera që mund të rrisin të ardhurat dhe fitimin e tyre. Sipërmarrjet, në disa raste, nuk marrin orientimet e duhura për të operuar dhe administruar bizneset e tyre sepse:

1. Këto shërbime nuk kërkohen nga klientët e studios kontabël, duke gjykuar se këto shërbime nuk janë pjesë e aktivitetit të studios.

2. Punonjësit e studios kontabël nuk bëjnë përpjekjet e duhura, për të dhënë sugjerimet dhe opinionet e tyre. në raste kur mund të jetë e nevojshme.

Pikërisht ky është edhe synimi ynë. Ne pretendojmë që të ndërtojmë një strukturë dhe mënyrë pune ku bëhemi pjesë e administrimit financiar të klientëve tanë.

Kështu duke përmbushur misionin tonë, orientimin e bizneseve dhe këshillimin për tu fokusuar në aktivitete sa më fitimprurëse dhe afatgjata dhe duke këshilluar bizneset për tu larguar nga përfshirja në aktivitete me risk të lartë ose jo-fitimprurëse.

Nga eksperiencia jonë, mënyra më e mirë për të arritur këtë nivel të shërbimit, është duke dëgjuar me kujdes rastin tuaj dhe duke ndjekur më pas, me po kaq kujdes, zbatimin e tij. Për këtë ne marrim gjithë kohën e nevojshme për të qenë pranë Jush dhe njohur me rastin tuaj.

Paketa e plotë e shërbimeve të këshillimit financiar.

- ✓ Përgatitja e buxheteve të ndryshme dhe rishikimi i tyre.
- ✓ Analizë dhe orientim për hapjen e bizneseve të reja.
- ✓ Analizë e performancës së biznesit tuaj.
- ✓ Përgatitja e raporteve të ndryshme për investime të mundshme në të ardhmen.

Ne ju ftojmë që të përfitonit nga konsultimi ynë i parë falas për të diskutuar rreth kërkesave apo pyetjeve tuaja për idetë dhe projekte tuaja. Ju lutemi telefononi në +355693232349, ose shkruani në [info@alprofitconsult.al](mailto:info@alprofitconsult.al) për të lënë një takim.

## Regjistrimi i Bizneseve

Ne mund t'ju ndihmojmë me regjistrimin fillestar të biznesit dhe ndryshime të tjera.

Pjesë e rëndësishme e shërbimeve të studios sonë të kontabilitetit është këshillimi dhe më pas ndjekja e procesit të regjistrimit fillestar dhe ndryshimeve të tjera në të dhënat e regjistrimit të bizneseve.

Ky shërbim është pjesë shumë e rëndësishme e punës tonë të përditshme, por për ne ai nuk është shërbim rutinë dhe proces i parëndësishëm e “punë që duhet të bëhet”. Përkundrazi, ne vlerësojmë që ky shërbim është shumë i rëndësishëm, dhe për fat të keq, sipërmarrjet nuk marrin shërbim cilësor, ose nuk vlerësohet sa duhet.

Në pjesën më të madhe të rasteve, ky shërbim ofrohet nga zyrat e kontabilitetit, si një aktivitet rastësor, dhe, që nuk mund të kryhet nga aktorë të tjerë të lidhur me të. Ose shpesh bizneset nuk marrin kohën e nevojshme për të gjetur formën dhe mënyrën më të mirë të regjistrimit fillestar.

Vendimi për formën e regjistrimit fillestar të biznesit do të ndikojë në shumën e taksave që kjo sipërmarrje do të paguajë në të ardhmen. Shpesh hasen regjistrime të bizneseve, në një formë ose status që nuk përputhet me faktin dhe pritshtmëritë që ka sipërmarrja.

Forma e regjistrimit fillestar (p.sh. person fizik apo shoqëri), statusi i duhur tatimor (nëse do të jetë biznes i madh, subjekt ose jo i TVSH), koha e humbur nga sipërmarrjet në sportelet e regjistrimeve të bizneseve sepse nuk kanë informacion të nevojshëm, lënia e bizneseve pa plotësuar deklaratat tatimore sepse biznesi nuk ka informacionin për kalimin në status pasiv, mungesa e informacionit për çregjistrimin e biznesit etj.

Ne do të vlerësojmë së bashku rastin tuaj, diskutojmë më pas të gjitha alternativat dhe më pas marrjen e vendimit për formën e regjistrimit. Ne do të ndjekim më pas të gjitha format e ndryshimeve në regjistrim dhe këshillojmë e ndjekim nga afër bashkëpunimin me zyrën tuaj juridike.

Ndryshimet e fundit në fushën e regjistrimeve të bizneseve dhe marrja e pothuajse të gjitha dokumenteve në formë elektronike, bën që ky shërbim të jetë më tepër i rëndësishëm dhe lehtësisht i prekshëm për sipërmarrjet.

- ✓ Paketa e plotë Regjistrimit të Bizneseve
- ✓ Regjistrimi fillestar i biznesit
- ✓ Ndryshime të ndryshme në regjistrim
- ✓ Përditësim i të dhënave
- ✓ Çregjistrimi i bizneseve nga regjistri tregtar

Ne ju ftojme që të përfitoni nga konsultimi ynë i parë falas për të diskutuar rreth idesë suaj për regjistrimin e një sipërmarrje dhe situatën tuaj. Ju lutemi telefononi në +355693232349, ose shkruani në [info@alprofitconsult.al](mailto:info@alprofitconsult.al) për të lënë një takim.

## Intuit QuickBooks

Ne mund të instalojmë, trajnojmë dhe ndjekim implementimin e plotë të programit financiar QuickBooks

Konsiderohet një nga platformat më të përdorura për administrimin kontabël dhe financiar në të gjithë botën. Lehtësia në përdorim, fleksibiliteti, njohja e tij nga përdoruesit në shkallë më të gjerë, kostoja relativisht e ulët, mundësia e madhe e përzgjedhjeve, etj.

Ka shumë arsye për të cilat mund të rekomandohet përdorimi i kësaj platforme për të administruar informacionin financiar në sipërmarrjen tuaj.

AlProfit Consult mund t'ju ndihmojë në implementimin e plotë të QuickBooks, duke filluar nga instalimi (pa kosto), trajnimi dhe ndjekja në vijimësi, e përshtatjes së plotë të programit më të përdorur financiar pranë Jush.

Lehtësia e konfigurimit, shembuj dhe udhëzime të vetë aplikacionit, Ju lejojnë që të përdorni atë, edhe pa qenë nevoja të jeni ekonomist apo ekspert i fushës. I krijuar dhe përshtatur për ti ardhur në ndihmë, kryesisht kompanive të vogla dhe të mesme, ai mund të përdoret nga të gjitha kompanitë, në të gjitha fushat.

Paketa e plotë e implementimit të QuickBooks

- ✓ Instalimi (pa kosto) i programit financiar
- ✓ Konfigurimi fillestar dhe personalizimi në rastin tuaj
- ✓ Trajnimi i personelit përgjegjës
- ✓ Implementimi i plotë dhe ndjekje e vazhdueshme

Do të ishim mjaft të gatshëm për të prezantuar QuickBooks tek Ju dhe jemi të bindur që do të ndryshojë tërësisht perceptimin tuaj për rolin e programit të kontabilitetit. Ju lutemi telefononi në +355693232349, ose shkruani në [info@alprofitconsult.al](mailto:info@alprofitconsult.al) për të lënë një takim.

## Kurse Kontabiliteti

Ne mund t'ju ndihmojmë me kurse të kontabilitetit praktik dhe mundësinë e zhvillimit të praktikës profesionale

Ne besojmë që profesioni i ekonomistit është i lidhur shumë ngushtë me leximin e vazhdueshëm dhe njohjen me praktikën më të mira. Njohja me shumë profesionistë të fushës ka përforcuar bindjen tonë që ky është kushti kryesor i të pasurit sukses.

Programet e ndryshme të kurseve praktike, në fushën e kontabilitetit, janë një mundësi mjaft e mirë për çdo koleg të ri, ose praktikues apo pjestar të menaxhimit të sipërmarrjeve, për të kuptuar më shumë rreth profesionit të ekonomistit.

Meqenëse një pjesë e mirë e detyrave tona është e lidhur shumë ngushtë me trajnimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të ekonomistëve dhe menaxherëve në marrjen e vendimeve, aktiviteti i këshillimit dhe trajnimit ka lindur shumë natyrshëm në zyrën tonë të kontabilitetit.

Ne zhvillojmë kurse të vazhduara të kontabilitetit praktik, kryesisht me grupe shumë të vogla, maksimumi 6 persona. Kjo, sepse ne besojmë që kursi, më shumë se sa shpjegimi i termave apo mësimi pasiv i një programi kontabiliteti, është mësimi i shprehive të nevojshme të profesionit të ekonomistit.



Tek ne do të gjeni profesionistë me eksperiencë, përkushtim maksimal gjatë dhe pas organizimit të kursit, këshillim dhe mundësi për gjetjen e vendeve të reja të punës, nga klientët tanë apo rrjeti ynë i bashkëpunëtorëve.

Ne përdorim metodat më të fundit bashkëkohore dhe programet më të personalizuar në rastin tuaj. Gjatë gjithë kohës së trajnimit, Ju do të konsideroheni pjesë e stafit tonë dhe do të keni mundësi angazhimi në çështje, praktike dhe aktivitete me klientët tanë.

Ju do të keni mundësi të angazhoheni direkt në detyrat tona të përditshme, të punoni me disa nga kolegët tanë, përfshihen në projektet me klientët, merrni pjesë në aktivitetet faktike të zyrës dhe klientëve, punoni direkt me ekspertët më të suksesshëm, të kontaktoni me kolegë brenda dhe jashtë vendit dhe shumë aktivitete të tjera.

Ne do të punojmë së bashku për të gjetur programin më të përshtatshëm për ju. Do t'ju dëgjojmë për të kuptuar rreth formimit tuaj, pikave tuaja të forta, por dhe të dobëta. Do të njihemi me programet tuaja afatmesme dhe afatgjata, dhe së bashku do të hartojmë programin tuaj të kursit.

Paketa e plotë e kurseve të kontabilitetit.

- ✓ Informimi paraprak mbi programet e trajnimit
- ✓ Njohja me stadin tuaj të zhvillimit profesional
- ✓ Gjetja e programit më të përshtatshëm të trajnimit
- ✓ Përfshirja në listën e rekomandimeve për mundësi punësimi
- ✓ Komunikim i vazhduar periodik pas përfundimit të trajnimit
- ✓ Rekomandimin tonë për punësime apo angazhime në të ardhmen.

Ne ju ftojmë që të përfitoni nga seanca e parë falas e kursit të kontabilitetit. Ju lutemi telefononi në +355693232349, ose shkruani në [info@alprofitconsult.al](mailto:info@alprofitconsult.al) për të lënë një takim.

## **KONTAKT**

Adresa: Rruga e Elbasanit, Pallati Fratari, Shkalla 1, Kati 6, Apartamenti 27, Tiranë

Telefon: +355 693232349

Web: [www.alprofitconsult.al](http://www.alprofitconsult.al)

E-mail: [info@alprofitconsult.al](mailto:info@alprofitconsult.al)